



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.814/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-80757-07-26-2018 me objekt “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Kukës”-faza I (blloku operator dhe urgjenca, maternitetit, administrata), me fond limit 163.832.500 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 10.09.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukës.

Ankimues:

BOE “Lala” & “Shansi Invest” shpk & “Biba-X” shpk
Lagje Nr.1, Qyteti Krumë, Kukës

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukës
Lagjja 7, Qyteti Kukës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:


I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 26.07.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-80757-07-26-2018 me objekt “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Kukës”-faza I (blloku operator dhe urgjenca , maternitetit, administrata), me fond limit 163.832.500 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 10.09.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukës.

II.2. Në datën 10.09.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 03.10.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Lala	150,726,332	I skualifikuar
- Be-Is	154,573,735.11	I kualifikuar
- Curri	162,719,557.08	I kualifikuar
- Elda-VI	pa ofertë	I skualifikuar
- Royal Berat	300,000	I skualifikuar

II.4. Në datën 17.10.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Lala	150,726,332	I skualifikuar
- Be-Is	154,573,735.11	I skualifikuar
- Curri	162,719,557.08	I kualifikuar
- Elda-VI	pa ofertë	I skualifikuar
- Royal Berat	300,000	I skualifikuar

II.5. Në datën 03.10.2018 BOE “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tyre në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

S’kualifikohet se nuk paraqiti :

1. Kapaciteti teknik nuk ka paraqitur nje Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit të prokuruar, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure).

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit ne vlerë jo më të vogël se 200% e fondit të prokuruar (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure).

Kontratat e paraqitura nga subjektet e bashkimit te operatoreve ekonomike nuk jane te njejta me objektin e prokurimit , pra nuk jane kontrata te ngjashme(kontrata pune rikonstruksion godine) si dhe kryesuesi i bashkimit, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3.1 ne Dokumentat standarte te tenderit , duhet të plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Pra për rastin konkret kryesuesi i këtij bashkimi nuk ka paraqitur kontratë pune të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit të prokuruar, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. Por edhe i gjithë bashkimi i operatoreve ekonomike në total nuk ka paraqitur kontrata pune të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit ne vlerë jo më të vogël se 200% e fondit të prokuruar.

2. Në akt marrëveshje përcaktohet qartë ndarja në %-je të punimeve që do të realizojë secila nga shoqëritë por në tërësinë e kategorive të punimeve që përmban preventivi ka raste kur %-ja e punimeve në total është me e lartë se 100% , dhe që nënkupton se nuk ka një ndarje të qartë të shprehur në % në raport me %-en e deklaruar dhe konkretisht : “LALA”shpk “Biba X”shpk “Shansi invest”shpk

- .2.426 Prishje mur tulle pa pastrim 26% 31% 44%
- 2.426/6 Prishje mure beton/arme 33% 33% 33%
- Analiz Heqje dyer dritare duralumini të ripërdorshme 38% 50% 13%, =101%
- 2.291 Bordura trotuari 25x12cm të derdhura në vend 50% 33% 18%, =101%
- 2.114/1 Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m³ C - 16/20. 62% 31% 8%, = 101%
- Heqje zgara dritare ekzistuese 63% 25% 13%, =101%
- 2166 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm 38% 44% 19%, =101%
- 2.300 Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah 50% 32% 19%, =101%
- 2.491/c F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, PN . 16 48% 40% 13%, =101%
- 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks (d54x9) 44% 19% 38%, =101%
- 2.494 F.V Saracineska bronzi Ø ½ " = 15 mm 63% 25% 13%, =101%
- 2.494/1 F.V Saracineska bronzi Ø ¾ " = 20 mm 56% 17% 28% =101%
- 2.493/1 F.V.Tubo çeliku pa tegel ASTM, A106GR DN 4" 35% 35% 31% , =101%
- Sistemi i shkarkimit të ujrave të zeza 42% 33% 26% =101%

3. Kontrata me Inxhinierin e ndertimit z.Agur Shehaj ka mosperputhje të dates se lidhjes se kontrates me daten e hyrjen ne fuqi te saj , pasi ajo është lidhur me date 12.03.2015 por ne nein 4 te saj shprehet se kjo kontrate lidhet nga data 02.01.2015 dhe ne Kodin e Punes nuk njihen kontratat me prapaveprim , pra na shtyn te besojme ne fiktivitetin e kesaj kontate.

4. Kontrata me Inxhinierin e ndertimit z.Genc Ajazi ka mosperputhje të dates se lidhjes se kontrates me daten e hyrjen ne fuqi te saj , pasi ajo është lidhur me date 13.02.2017 por ne nein 4 te saj shprehet se kjo kontrate lidhet nga data 28.01.2017 dhe ne Kodin e Punes nuk njihen kontratat me prapaveprim , pra na shtyn te besojme ne fiktivitetin e kesaj kontate.

5. Inxhinieria z.Dallendyshe Cengu nuk është ne Licencen nr. NZ .4319/5 te subjektit Biba –X shpk.

II.5. Në datën 09.10.2018, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Së pari në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit të ofertës ekonomike të paraqitur nga BOE “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk kontratat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi nga i gjithë bashkimi i operatorëve janë si më poshtë:

1. Rehabilitimi i linjës së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në qytetin e sarandës shqipëri-945,844,531 Lala/Shansi Invest shpk

2. Rikonstruksion Rr .Pashtriku trotuaret qendër Golaj, muri mbajtës, sistemim shtrati, Gurra domaj dhe rikonstruksion Ujësjiellësi Cahan-29,785,265 lekë –Lala shpk
 3. Rikonstruksion Rr. Pashtrikut, trotuaret qendër Golaj, muri mbajtës, sistem shtrati, Gurra Domaj dhe rikonstruksion Ujësjiellësi Cahan Shtesë Kontrate- 4,147,000 lekë-Lala shpk
 4. Rikonstruksion i Ujësjiellësit të fshatit Krume dhe Zaharisht (Vazhdim)-83,168,267 lekë-Lala shpk
 5. Ndërtim –montim linje 110 kv Peshkopi Lapaj së bashku me dy daljet përkatëse 110 kv të N/st Peshkopi dhe N/st Lapaj-374,056,485 lekë-Shansi Invest
 6. Godinë Banimi dhe Shërbimi 1,2,3,4,5 Kt+nëncati+Ikat nëntokë- 44,863,653 lekë - Shansi Invest
 7. Rindërtim i kaskadës së dëmtuar mbi lumin Dunavec në zonën Vashtëmi Korçë- 137,410,995 lekë-Shansi Invest
 8. Rikonstruksion , sistemim she asfaltim sheshesh-61,235,668 lekë-Biba X shpk
 9. Rehabilitim i kanaleve sekondare Peqin Kavajë në teritorin e Bashkisë Rrogozhinë- 33,415,037 lekë-Biba X shpk.
- Vlera Totale e Kontratave 1,713,926,901 lekë pa tvsh.

Në tabelën më sipër janë paraqitur vetëm vlerat e realizuara nga anëtarët e këtij bashkimi (për rastet kur kontratat janë realizuar me operatorë të tjerë ekonomikë).

Vlera e kërkuar në DST për një kontratë të ngjashme është me vlerë 81,916,250 lekë pa tvsh (50% e vlerës së kontratës që prokurohet).

Vlera e kërkuar në DST për disa kontrata të ngjashme është me vlerë 327,665,000 lekë pa tvsh (200% e vlerës së kontratës që prokurohet). Vlera totale e kontratave të ngjashme të paraqitura nga BOE e përfaqësuar nga shoqëria Lala shpk është 1,713,926,901 lekë pa tvsh.

Kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik Lala shpk që të cilësohet si eksperiencë e ngjashme duhet parë në raport me natyrën e punimeve dhe lementëve konkretë të realizimit të tyre (zërat e preventivit) që autoriteti kontraktor synon të realizojë në cilësinë e investitorit pas lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik të klasifikuar të suksesshëm. Natyra e objektit të tenderuar është një natyrë punimesh të ndryshme prandaj për përmbushjen e kriterit të eksperiencave të mëparshme të ngjashme përlllogaritet duke verifikuar në mënyrë kumulative zërat e preventivit bashkëngjitur kontratës së ngjashme të paraqitur nga ana jonë. Konkretisht kontrata me objekt Rehabilitimi i linjës së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në qytetin e Sarandës e realizuar nga shoqëria Lala shpk dhe Shansi Invest shpk është e përbërë nga punime të ndryshme të cilat janë pasqyruar duke krahasuar zërat e preventivit të tenderuar me situacionin përfundimtar të këtij objekti . Për këtë objekt punime të ngjashme të realizuara nga shoqëria Lala shpk kapin vlerën 394,827,211 lekë pa tvsh pra duke e plotësuar dhe tejkalluar disa herë pikën 1/a për një kontratë të vetme sa 50% e fondit limit. Po ashtu dhe shoqëria Shansi Invest ka realizuar punime të ngjashme me zërat e preventivit të tenderuar me vlerë 395,822,663 lekë pa tvsh. Gjithashtu shoqëria Biba X shpk ka paraqitur pune të ngjashme me vlerë 94,650,705 lekë pa tvsh në përputhje me zërat e preventivit të tenderuar nga AK .

Sa më sipër pretendimi i KVO në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.

2. Së dyti në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se kemi paraqitur kontratën e bashkëpunimit datë 10.09.2018 nr.1674 Rep Nr.849 Kol ku shprehet qartë se shoqëria “Lala” shpk merr përsipër kryerjen e 40 % të punimeve, shoqëria Shansi Invest shpk 30% të punimeve dhe shoqëria Biba X 30% të punimeve. Gjithashtu pjesë e kontratës së bashkëpunimit është dhe tabela e ndarjes së punimeve ku është përcaktuar për secilin zë punimesh sasia totale, cmimi i ofertuar, vlera totale e cila përfaqëson 100% të zërit konkret të punimeve). Gjithashtu kemi bërë ndarjen për secilin zë punimesh , për secilën kompani, ku kemi dhënë sasinë e punimeve që merr secila kompani për secilin zë punimesh , cmimin e ofertuar dhe vlerën që i korenspondon secilës kompani për secilin zë punimesh kjo e shprehur edhe në përqindje. Për më tepër sasia dhe vlera që përfaqësojnë të tre kompanitë përbën 100% të sasisë dhe vlerës për secilin zë punimi as më pak dhe as më shumë. KVO e AK duhet të ketë parasysh faktin se në momentin e reflektimit të përqindjeve shifrat mbas presjeve nuk janë reflektuar pasi ishin lidhje periodike ose shumë të gjata (në varësi nga mënyra e ndarjes të sasive të preventivit) ka rezultuar si vijon psh: zëri i punimeve Prishje mure betoni/arme e ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet 3 kompanive me nga 33,33 e paraqitur në tabelën e ndarjes së punimeve me nga 33%,33%, 33%. Kjo nuk do të thotë se ndarja e punimeve nuk është bërë për 100% të zërit të punimeve por që në momentin e reflektimit të përqindjeve nga mënyra si është ndarë ky zë (në mënyrë të barabartë) ka bërë që 1% të mos reflektohet.

Gjithashtu për Sistemi i Shkarkimit të Ujrave të Zeza kemi paraqitur vlerën totale të ofertuar 4,799,510 lekë pa tvsh përfaqëson 100% si dhe vlerat për secilën kompani konkretisht shoqëria Lala 1,998,150 lekë pa tvsh, Shansi Invest 1,227,910 lekë, shoqëria Biba X 1,573,450 lekë pa tvsh.

Përqindja për secilën kompani paraqitet: Shoqëria Lala shpk 1,998,150 lekë pa tvsh/4,799,510 lekë pa tvsh*100%=41.63 % e rrumullakosur me 42%

Shoqëria Shansi Invest shpk $1,227,910/4,799,510*100%=25.58%$ e rrumullakosur me 26%

Shoqëria Biba X $1,573,450/4,799,510*100%=32.78%$ e rrumullakosur me 33%.

Përqindja që përfaqëson secila kompani pa shifra pas presjes (me rrumullakosje) është $42%+26%+33%=101%$

Përqindja që përfaqëson secila kompani me dy shifra pas presjes është $41.63%+25.58%+32.78%=99.99%$.

Pra 1% reflektohet me vlerë më të madhe për shkak të ndarjes në përqindje me më shumë se dy shifra pas presjes. I njëjti arsyetim vlen edhe për zërat e tjerë të pretenduar nga AK. Sa më sipër pretendimi i KVO nuk qëndron.

3. Së treti në lidhje me arsyen e skualifikimit lidhur me inxhnierët sqarojmë se: BOE ka paraqitur me cilësinë e inxhinierit hidroteknik stafin si më poshtë:

1. Ing Augur Shehaj

2. Ing genc Ajazi

3. Ing Islam Lika

4. Ing Dallëndyshe Cengu

Referuar diplomës së paraqitur për Ing Augur Shahaj dhe Ing Genc Ajazi rezulton se ata kanë fituar titullin Inxhinier Ndërtimi me specialitet Ndërtime Hidroteknike rruga ura. Referuar titullit të diplomimit viti 1972/1968 këta inxhinierë janë të diplomua me specialitet punimet hidroteknike. Ing Genc Ajazi disponon licencën Z.4236 me titull Ing Hidroteknik Rruga Ura. Pra nga një inxhinier hidroteknik që autoriteti kontraktor ka kërkuar në DST nga ana jonë kemi paraqitur 4 inxhinierë hidroteknik jo vetëm duke plotësuar këtë kriter por edhe duke e tejkaluar atë.

- Në cilësinë e Ing Ndërtimi kemi paraqitur:

1. Ing Ervin Lako

2. Ing Festim Burza

3. Ing Arjol Gradica

4. Ing Elidon Kallaverja

5. Ing Kloida Elezi

6. Ing Dorjan Anxheliu

Shoqëria Lala ka paraqitur për Ing Augur Shehaj kontratën individuale të punës Nr.369 Rep Nr.166/1 Kol nënshkruar më datë 12.03.2018. Në nenin 4 palët kanë parashikuar afatin e kontratës 5 vjecare duke filluar nga 02.01.2015 deri më 01.01.2020. Ing Augur Shehaj në momentin e nënshkrimit të kontratës individuale të punës nr.369 rep nr.166/1 kol nënshkruar më datë 12.03.2018 ka qenë në marrëdhënie pune me shoqërinë Lala shpk sipas kontratës së punës datë 18.01.2011 Nr.247 Rep Nr.51 Kol me afat 5 vjecar. Kjo është e provuar edhe me shënimin në fund të kontratës individuale të punës nr.369 Rep Nr.166/1 Kol nënshkruar më datë 12.03.2018 ku përcaktohet se kontrata e punës datë 08.01.2011 Nr.247 Rep Nr.51 Kol shfuqizohet dhe mbetet pa efekte juridike. Për këtë inxhinier janë respektuar të gjitha dispozitat e kontratës së parë të punës po ashtu edhe dispozitat e kontratës aktuale.

- I njëjti arsyetim vlen edhe për Ing Genc Ajazi e paraqitur nga shoqëria Shansi Invest i cili ka qenë në marrëdhënie pune me këtë shoqëri edhe para kontratës ekzistuese.

- Shoqëria Biba X shpk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për Ing. Hidroteknik Dallëndyshe Cangu (kontrata pune, diploma, Cv dhe librezë pune) e cila rezulton në listpagesat e kësaj shoqërie Janar 2016 duke përfshirë periudhën e kërkuar nga AK në DST Janar 2018 e në vazhdim.

Sa më sipër pretendimi i i AK në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.

II.6. Në datën 18.10.2018 me shkresën nr. 1045 prot datë 16.10.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “BOE “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 24.10.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1104 prot datë 01.11.2018 protokolluar me tonën me nr.1636/2 datë 02.11.2018 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se “Në akt marrëveshje përcaktohet qartë ndarja në %-je të punimeve që do të realizojë secila nga shoqëritë por në tërësinë e kategorive të punimeve që përmban preventivi ka raste kur %-ja e punimeve ne total eshte me e larte se 100% , dhe që nënkupton se nuk ka një ndarje të qartë të shprehur në % në raport me %-en e deklaruar dhe konkretisht : “LALA”shpk “Biba X”shpk “Shansi invest”shpk - .2.426 Prishje mur tulle pa pastrim 26% 31% 44%; 2.426/6 Prishje mure beton/arme 33% 33% 33% ; Analiz Heqje dyer dritare duralumini të ripërdorshme 38% 50% 13%, =101%; 2.291 Bordura trotuari 25x12cm te derdhura ne vend 50% 33% 18%, =101%; 2.114/1 Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m3 C - 16/20. 62% 31% 8%, = 101%; Heqje zgara dritare ekzistuese 63% 25% 13%, =101%; 2166 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm 38% 44% 19%, =101%; 2.300 Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah 50% 32% 19%, =101%; 2.491/c F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, PN . 16 48% 40% 13%, =101%; 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks (d54x9) 44% 19% 38%, =101%; 2.494 F.V Saracineska bronzi Ø ½ " = 15 mm 63% 25% 13%, =101%; 2.494/1 F.V Saracineska bronzi Ø ¾ " = 20 mm 56% 17% 28% =101%; 2.493/1 F.V.Tubo çeliku pa tegel ASTM, A106GR DN 4" 35% 35% 31% , =101%; Sistemi i shkarkimit te ujrave te zeza 42% 33% 26% =101%”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Operatorët ekonomikë “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr.1674 rep Nr.849 Kol datë 10.09.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit

“Rikonstrukcion i Spitalit Rajonal Kukës”-faza I (blloku operator dhe urgjenca , maternitetit, administrata), me fond limit 163.832.500 leke pa TVSH, zhvilluar nga Spitali Rajonal Kukës.

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Shoqëria Lala shpk do të kryejë 40% të punimeve sipas tabelës së ndarjes së punimeve. Shoqëria Shansi Invest shpk do të kryejë 30% të punimeve sipas tabelës së ndarjeve të punimeve. Shoqëria Biba X shpk do të kryejë 30% të punimeve sipas tabelës së ndarjeve të punimeve [...]

III.1.2. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

III.1.3. KPP konstaton se bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit BOE ankimes ka paraqitur tabelën e ndarjes së punimeve në përqindje midis tre anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë. Nga shqyrtimi i preventivivit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes KPP konstaton se për zërat e punimeve me emërtimin - Prishje mur tulle pa pastrim 2.426/6 Prishje mure beton/arme; Analiz Heqje dyer dritare duralumini të ripërdorshme , 2.291 Bordura trotuari 25x12cm te derdhura ne vend 2.114/1 Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m3 C - 16/20; 2166 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm; 2.300 Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah; 2.491/c F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, PN 16; 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks (d54x9) ; 2.494 F.V Saracineska bronzi Ø ½ " = 15 mm; 2.494/1 F.V Saracineska bronzi Ø ¾ " = 20 mm ; 2.493/1 F.V.Tubo çeliku pa tegel ASTM, A106GR DN 4"; Sistemi i shkarkimit te ujrave te zeza; mbledhja e përqindjeve që secili anëtar ka marrë përsipër për secilin prej këtyre zërave del 101 % pra më e madhe se 100%. Akoma më tej KPP kontaton se disa nga zërat e sipërcituar rezultojnë të jenë përshkuar disa herë në preventiv me përqindje të ndryshme si psh zërat 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks (d54x9), 2.494/1 F.V Saracineska bronzi Ø ¾ " = 20 mm.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ka një mospërputhje ndërmjet përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit dhe përqindjes së përcaktuar në preventiv.

Lidhur me pretendimin e BOE ankimes se “Gjithashtu për Sistemi i Shkarkimit të Ujrave të Zeza kemi paraqitur vlerën totale të ofertuar 4,799,510 lekë pa tvsh përfaqëson 100% si dhe vlerat për secilën kompani konkretisht shoqëria Lala 1,998,150 lekë pa tvsh, Shansi Invest 1,227,910 lekë,

shoqëria Biba X 1,573,450 lekë pa tvsh. Përqindja për secilën kompani paraqitet: Shoqëria Lala shpk 1,998,150 lekë pa tvsh/4,799,510 lekë pa tvsh*100%=41.63 % e rrumullakosur me 42% Shoqëria Shansi Invest shpk 1,227,910/4,799,510*100%=25.58% e rrumullakosur me 26% Shoqëria Biba X 1,573,450/4,799,510*100%=32.78% e rrumullakosur me 33%.Përqindja që përfaqëson secila kompani pa shifra pas presjes (me rrumullakosje) është 42%+26%+33%=101%. Përqindja që përfaqëson secila kompani me dy shifra pas presjes është 41.63%+25.58%+32.78%=99.99%. Pra 1% reflektohet me vlerë më të madhe për shkak të ndarjes në përqindje me më shumë se dy shifra pas presjes. I njëjti arsyetim vlen edhe për zërat e tjerë të pretenduar nga AK, KPP e gjen të pabazuar pasi koncepti i rrumullakosjes së përqindjeve nuk gjen zbatim në rastin konkret dhe as nuk përputhet me përcaktimet e nenit 74 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar, pasi e bën të pamundur procesin e vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në funksion të përmbushjes së kriterëve.

Qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 74 pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është që ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Për këtë shkak ndarja e përqindjes për zërat konkretë duhet të jetë strikte, e mirpërcaktuar dhe në cdo rast të përputhet me atë masë përqindje që ka marrë përsipër të realizojë secili prej anëtarëve në kontratën e bashkëpunimit.

Bazuar në këtë mospërputhje, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim shoqërisht (kontrata e bashkëpunimit dhe preventivi i paraqitur) nuk është hartuar në formën e duhur ligjore sipas parashikimeve të VKM nr. 914 datë 29.12.2014“Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm, ndaj skualifikimi i bërë nga autoriteti kontraktor për këtë shkak, është i drejtë. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve, është një element i rëndësishëm në një procedurë prokurimi në procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, për faktin se në bazë të kësaj përqindje të caktuar, në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktor do të bëjë edhe verifikimin e dokumentacionit dhe përmbushjen e kriterëve në përputhje me përqindjen e caktuar për të gjithë elementët si kapacitet ligjor, teknik, ekonomik – financiar etj., (kontrata të ngjashme, numri i punonjësve, mjetet, licencat, certifikimet, dokumentacion ligjor etj). Në rastin konkret, kur kemi të bëjmë me një mospërputhje të ndarjes së përqindjes së caktuar në kontratën e bashkëpunimit me atë përqindje të caktuar në preventivin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, mospërputhje kjo në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit në fuqi, e cila ka efekt në lidhje me plotësimin e kriterëve nga ana e secilit anëtar të bashkimit të operatorëve ekonomikë, fakt ky i pranuar edhe nga vetë ana e operatorit ekonomik ankimes, automatikisht nuk është e mundur të bëhet verifikimi i përmbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nga ana e operatorit ekonomik, në përputhje me përqindjen e caktuar, në kushtet kur kjo përqindje është e ndryshme pra nuk është një përqindje e saktë dhe rrjedhimisht dhe verifikimi i dokumentacionit është i pamundur të verifikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Akoma më tej referuar deklarimeve të vëtë ankimuesit në ankesë ky i fundit pranon se ka mospërputhje midis ndarjes në përqindje në kontratën e bashkëpunimit dhe ndarjes në përqindje në preventivin e punimeve në masën 1% për zërat e sipërcituar duke pretenduar se *“AK duhet të ketë parasysh faktin se në momentin e reflektimit të përqindjeve shifrat mbas presjeve nuk janë reflektuar pasi ishin lidhje periodike ose shumë të gjata (në varësi nga mënyra e ndarjes të sasive të preventivit) ka rezultuar si vijon psh: zëri i punimeve Prishje mure betoni/arme e ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet 3 kompanive me nga 33,33 e paraqitur në tabelën e ndarjes së punimeve me nga 33%,33%, 33%. Kjo nuk do të thotë se ndarja e punimeve nuk është bërë për 100% të zërit të punimeve por që në momentin e reflektimit të përqindjeve nga mënyra si është ndarë ky zë (në mënyrë të barabartë) ka bërë që 1% të mos reflektohet.*

Në këtë kuptim, Komisioni gjykon se ankimuesi në kushtet kur edhe vetë pranon se nuk ka bërë ndarje të saktë të përqindjeve në preventivin e punimeve për secilin nga anëtarët e bashkimit përqindje e cila nuk përputhet me atë të përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit për secilin anëtar është i destinuar të dështojë në realizimin me sukses të kësaj kontrate.

Bazuar në këtë mospërputhje, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim shoqërisht (kontrata e bashkëpunimit dhe preventivi i paraqitur) nuk janë hartuar në formën e duhur ligjore sipas parashikimeve të VKM nr. 914 datë 29.12.2014“Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm, ndaj skualifikimi i bërë nga autoriteti kontraktor për këtë shkak, është i drejtë.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “Lala” & “Shansi Invest” shpk & “Biba-X” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-80757-07-26-2018 me objekt “Rikonstruktion i Spitalit Rajonal Kukës”-faza I (blloku operator dhe urgjenca , maternitetit, administrata), me fond limit 163.832.500 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 10.09.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukës.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1636 Protokolli; Datë 24.10.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Mendim Kundër

Mendim kundër i anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim KPP), znj. Lindita Skeja (Anëtar) dhe znj. Vilma Zhupaj (Anëtare).

Si anëtarë të KPP shprehim mendimin kundër arsyetimit të vendimit dhe rrjedhimisht edhe të dispozitivit të tij për sa i përket ankesës së paraqitur nga BOE “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk me objekt: *“Procedurë e Hapur”* me Nr.REF-80757-07-26-2018 me objekt *“Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Kukës”-faza I (blloku operator dhe urgjenca, maternitetit, administrata)*, me fond limit 163.832.500 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 10.09.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukës.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetojmë

Public Health Sector

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se *“1. Kapaciteti teknik nuk ka paraqitur nje Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:*

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit të prokuruar, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure).

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit ne vlerë jo më të vogël se 200% e fondit të prokuruar (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure).

Kontratat e paraqitura nga subjektet e bashkimit te operatoreve ekonomike nuk jane te njejta me objektin e prokurimit , pra nuk jane kontrata te ngjashme(kontrata pune rikonstruksion godine) si dhe kryesuesi i bashkimit, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.3.1 ne Dokumentat standarte te tenderit , duhet të plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Pra për rastin konkret kryesuesi i këtij

bashkimi nuk ka paraqitur kontratë pune të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit të prokuruar, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. Por edhe i gjithë bashkimi i operatoreve ekonomike në total nuk ka paraqitur kontrata pune të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit ne vlerë jo më të vogël se 200% e fondit të prokuruar”, vërejmë se

III.1.1. Operatorët ekonomikë “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr.1674 rep Nr.849 Kol datë 10.09.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Kukës”-faza I (blloku operator dhe urgjenca , maternitetit, administrata), me fond limit 163.832.500 leke pa TVSH, zhvilluar nga Spitali Rajonal Kukës.

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Shoqëria Lala shpk do të kryejë 40% të punimeve sipas tabelës së ndarjes së punimeve. Shoqëria Shansi Invest shpk do të kryejë 30% të punimeve sipas tabelës së ndarjeve të punimeve. Shoqëria Biba X shpk do të kryejë 30% të punimeve sipas tabelës së ndarjeve të punimeve [...]

III.1.2. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1 *Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:*

- a. *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së fondit të prokuruar, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure).*
- b. *Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit ne vlerë jo më të vogël se 200% e fondit të prokuruar (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te kesaj procedure).*

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

2.3.2 *Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:*

- a) *Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
 - *Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:*
 - *Kontratë,*
 - *Vertetim/e të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme tëpunëve.*
 - *Situacionin përfundimtar;*
 - *Aktin e kolaudimit;*

- *Fatura tatimore per cdo situacion punimesh. (ku të shprehen qartë datat, vlera,koha dhe natyra e punës së bërë)*
 - *Akt marrëveshjen e bashkëpunimit në rast se kontrata është fituar si bashkim operatorësh ekonomik.*
- b) *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
- *Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:*
 - *Kontrate;*
 - *Vërtetim/e ku të shënohen vlera,koha dhe natyra e punës së bërë.*
 - *Situacionin përfundimtar;*
 - *Akt kolaudimi objekti;*
 - *Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.*

Pika 2.3.2/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.2/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se BOE ankimeus në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Nr.1110 Prot datë 11.05.2016 me objekt “Rehabilitim i Kanaleve Sekondare Peqin Kavajë në teritorin e Bashkisë Rrogozhinë”, lidhur ndërmjet Bashkisë Rrogozhinë dhe BOE Biba X” shpk & “Senka” shpk; Formular Vlerësimi Bashkia Rrogozhinë lëshuar për BOE “Biba X” shpk & “Senka” shpk për kontratën me objekt “Rehabilitim i Kanaleve Sekondare Peqin Kavajë në teritorin e Bashkisë Rrogozhinë”. Data e fillimit të kontrës 12.05.2016 data e mbarimit 09.12.2016 me vlerë 57,282,921 lekë me tvsh. Biba X 70% dhe Senka 30%.; Situacion Nr.1 me vlerë 4,547,513 lekë pa tvsh; Faturë Tatimore Shitje Nr.44 datë 30.07.2016 lëshuar nga Bashkia Rrogozhinë me vlerë 4,547,513 lekë pa tvsh, Situacion nr.2 me vlerë 29,615,294 lekë pa tvsh, Faturë Tatimore Shitje Nr.86 datë 30.11.2016 me vlerë 29,615,294 lekë pa tvsh, Situacion Përfundimtar datë 27.12.2016, Faturë Tatimore Shitje për Situacionin përfundimtar, Akt Kolaudimi,, Akt Marrje e përkohshme në dorëzim të objektit, Procesverbal marrje në dorëzim përfundimtar të punimeve të objektit.
- Kontratë– Marrëveshje për punime ndërtimi dhe instalime me objekt “Rikonstruksion sistemim e asfaltim sheshesh datë 13 Shtator 2016 midis palëve Mektrin Motors shpk në cilësinë e punëshënsit dhe Biba X në cilësinë e kontraktorit, ofertë puimesh në vlerën 6,008,047 lekë pa tvsh, Formular Vlerësimi lëshuar nga Mektrin Motors shpk për Biba X shpk lidhur e objektin Rikonstruksion e asfaltim sheshesh me vlerë 73,482,801 lekë me

tvsh, Situacione, Procesverbal Kolaudimi, Situacion nr.7 në vlerën 61,235,667 lekë pa tvsh, Fatura Tatimore Shitje

- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Has për operatorin ekonomik “Lala” shpk për objektin e kontratës “Rikontruksion i Ujësjiellësit të fshatit Krumë dhe Zaharisht. Data e fillimit të kontratës Nr.1282 prot datë 06.06.2017 dhe data e mbarimit 13.04.2018 me vlerë 99,801,920 lekë me tvsh, Kontratë Sipërmarrje Nr.1282 prot datë 06.06.2017 me objekt “Rikontruksion i Ujësjiellësit të fshatit Krumë dhe Zaharisht, Situacion Përfundimtar datë 20.04.2018, Akt Kolaudimi, Fatura Tatimore Shitje.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Has për operatorin ekonomik “Lala” shpk për objektin e kontratës “Rikonstruksion Rruga Pashtrikut, trotualet qendër Golaj, muri mbajtës, sistemim shtrati Gurra Domaj dhe rikonstruksion Ujësjiellësi Cahan” me vlerë 35.742,318 lekë me tvsh. Data e fillimit të kontratës Nr.1893 prot datë 26.09.2016, data e mbarimit 14.08.2017. Kontratë Sipërmarrje Nr.1893 prot datë 26.09.2016 me objekt Rikonstruksion Rruga Pashtrikut, trotualet qendër Golaj, muri mbajtës, sistemim shtrati Gurra Domaj dhe rikonstruksion Ujësjiellësi Cahan”, lidhur ndërmjet Bashkia Has dhe shoqërisë Lala shpk., Situacione, Akt Kolaudimi, Akt dorëzimi, Fatura Tatimore Shitje.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Has për shoqërinë Lala shpk për objektin Rikonstruksion Rr. Pashtrikut , trotualet qendër Golaj, muri mbajtës sistemim shtrati Gurra Domaj dhe rikonstruksion Ujësjiellësi Cahan, Shtesë Kontrate. Data e fillimit të kontratës 15.12.2017-26.12.2017 me vlerë 4,976,400 lekë me tvsh.Shtesë Kontrate Nr.2655/1 datë 15.12.2017 , Situacion nr.1 dhe përfundimtar, Akt kolaudimi,Faturë Tatimore Shitje.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga shoqëria Bi & To Construction shpk për operatorin Shansi Invest për objektin e kontratës “Godinë banimi dhe shërbimi 1,2,3,4,5 KT+Nëncati+1 KT nëntokë. Data e fillimit të kontratës 06.05.2015, data e mbarimit 31.05.2016, me vlerë të kontratës 53,836,384 lekë me tvsh. Marrëveshje Nënkontraktimi , Situacion përfundimtar , Akt Kolaudimi, Akt Dorëzimi, Fatura Tatimore Shitje .
- Formular Vlerësimi lëshuar nga J/V Strabag AG&Trema Engineering 2 shpk për BOE Lala shpk& Shansi Invest shpk për objektin e kontratës “Rehabilitim i linjës së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në qytetin e Sarandës me vlerë të realizuar 6,873,940 euro pa tvsh. Lala shpk 45.6 % 3,134,172 euro pa tvsh,Shansi Invest shpk 54.4% 3,739,768 euro pa tvsh, Marrëveshje Nënkontraktimi, Kontratë Bashkëpunimi Lala&Shansi Invest, Certifikata e pranimit të përkohëshme dhe marrjes në dorëzim, Fatura Tatimore Shitje. Situacione. Referencë Punimesh lëshuar nga Ujësjiellës Kanalizime Sarandë për JV Shansi Invest& Lala shpk , Leje pranimit si nënkontraktor. Data e fillimit të kontratës 24.02.2015-, Data e mbarimit të kontratës 05.06.2017, Certifikata e Marrjes në Dorëzim.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga OST sha për Bashkimin e Operatorëve Shansi Invest shpk &Doko shpk për objektin e kontratës “Ndërtim montim linje 110 kv Peshkopi Lapaj së bashku me dy daljet përkatëse 110kv të N/st Peshkopi dhe N/st Lapaj. Data e fillimit të kontratës 13.05.2015-Data e mbarimit 22.07.2016, me vlerë të realizuar 480,072,494 lekë.

Shansi Invest shpk 93.5% dhe Doko shpk 6.5 %, Kontratë Nr.2962/8 prot datë 30.07.2014, Procesverbal Kolaudimi datë 11.08.2016, Fatura Tatimore Shitje, Situacion Nr.7 përfundimtar, Certifikatë e marrjes në dorëzim të objektit datë 11.08.2016.

- Formular Vlerësimi lëshuar nga UNDP Albania për shoqërinë Shansi Invest për kontratën Nr.00095774 me objekt “Loti 8 Ndërtimi i Kaskadës së re në lumin e Dunavecit në zonën e Korcës dhe punime mbrojtëse në të dyja anët e lumit pjesë e projektit Infrastruktura mbrojtëse nga përmbytjet. Data e fillimit të kontratës 17 Shtator 2015-Data e mbarimit të kontratës 19 Dhjetor 2016., me vlerë të realizuar 164,893,194 lek me tvsh, Kontratë Punimesh 15 Shtator 2015, Nr.00095774, Certifikatë pagesë përfundimtare, Procesverbal Kolaudimi, Certifikata e përfundimit të punimeve, Fatura Tatimore Shitje.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese aftësia teknike: *b) operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.5. Në nenin 26 “Kontratat e Punëve Publike”, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.”

III.1.6. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast për zgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.1.7. Gjykojmë se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi, në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë, konstatojmë se oferta e paraqitur është dorëzuar në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë, bashkim i krijuar me anë të kontratës së bashkëpunimit të lidhur para noterit publik në Republikën e Shqipërisë Nr.1674 rep Nr.849 Kol datë 10.09.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Kukës”-faza I (blloku operator dhe urgjenca , maternitetit, administrata), me fond limit 163.832.500 leke pa TVSH, zhvilluar nga Spitali Rajonal Kukës.

Sa më sipër, në përputhje me kriteret e veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi si edhe në respekt të parashikimeve të neneve 26 dhe 74 pika 3 të aktit nënligjor në zbatim të ligjit, në lidhje me dëshminë e eksperiencës së ngjashme kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatojmë se udhëheqësi i grupit referuar kontratës së bashkëpunimit, shoqëria “Lala” shpk në plotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit në drejtim të përmbushjes së kriterëve mbi dëshminë e eksperiencës së ngjashme, ka dorëzuar kontrata pune civile shoqëruar me situacion përfundimtar, akt dorëzimi i përkohshëm, Akt-Kolaudimi, Fatura Tatimore të shitjes dhe Formular Vlerësimi. Referuar Formularit të Vlerësimit dokumentacion i cili dëshmon se anëtari i bashkimit plotëson kriterin e kualifikimit për punë të ngjashme si për sa i përket natyrës dhe zërave të punimeve ashtu edhe vlerës së kërkuar. Sa më sipër, gjykojmë se me anë të dokumentacionit të sipërcituar, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Lala” shpk ka dëshmuar se plotëson gjurmën “a” të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet dëshmia e punëve të ngjashme të së njëjtës natyrë për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, si edhe në zbatim të nenit 26 dhe 74 pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Në lidhje me anëtarët e tjerë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shansi Invest” shpk, dhe “Biba X” shpk nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatojmë se në plotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit në drejtim të përmbushjes së kriterëve mbi dëshminë e eksperiencës së ngjashme, kanë dorëzuar kontrata pune dhe sipërmarrje shoqëruar me situacion përfundimtar, Certifikatë për marrjen në dorëzim të punimeve, Proces-Verbal Kolaudimi, Fatura Tatimore të Shitjes dhe Formular Vlerësimi. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biba X” shpk dhe “Shansi Invest” shpk kanë dëshmuar se plotësojnë gjurmën “a” të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet dëshmia e *punëve të ngjashme të së njëjtës natyrë për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% të vlerës së përlllogaritur të kontratës*, si edhe në zbatim të nenit 26 dhe 74 pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar i cili përcakton se anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Gjykojmë se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik plotësojnë kërkesën e autoritetit kontraktor për eksperiencat e ngjashme të realizuara më parë, pasi në to evidentohet se zërat e punëve të kryera janë të ngjashme me zërat e punëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në procesin e shqyrtimit të kontratave të paraqitura për eksperiencat e ngjashme të mëparshme duhet të fokusohet jo vetëm në titullin apo objektin e kontratës së ngjashme por duhet të analizojë të gjithëzërat e punëve, mallrave/ shërbimeve të kontratave të paraqitura, për të verifikuar dhe konkluduar më pas në kryerjen ose jo të zërave të tillë të ngjashëm në kontratat e realizuara më parë.

Gjithashtu, gjykojmë se autoriteti kontraktor nuk duhet të pretendojë për zërat të njëjtë shërbimi dhe të kërkojë eksperiencat të njëjta, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

Në këtë kuptim autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilat vendosen kriteret e përcaktuara.

Gjykojmë se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur (sikurse përcaktuar në nenin 46 si mësipërpërmendur), vërtetuar jo nëpërmjet dokumentave të tilla si kontratat e ngjashme shoqëruar me dokumentacionin përkatës siç është rasti i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pune të cilat janë realizuar kryesisht me institucione shtetërore.

Sa më sipër, gjykojmë se, ankimuesi e ka përmbushur kriterin e kualifikimit duke vërtetuar kështu se disponon kapacitetet në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se *“Në akt marrëveshje përcaktohet qartë ndarja në %-je të punimeve që do të realizojë secila nga shoqëritë por në tërësinë e kategorive të punimeve që përmban preventivi ka raste kur %-ja e punimeve në total është me e lartë se 100% , dhe që nënkupton se nuk ka një ndarje të qartë të shprehur në % në raport me %-en e deklaruar dhe konkretisht : “LALA”shpk “Biba X”shpk “Shansi invest”shpk - .2.426 Prishje mur tulle pa pastrim 26% 31% 44%; 2.426/6 Prishje mure beton/arme 33% 33% 33% ; Analiz. Heqje dyer dritare duralumini të ripërdorshme 38% 50% 13%, =101%; 2.291 Bordura trotuari 25x12cm te derdhura ne vend 50% 33% 18%, =101%; 2.114/1 Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m3 C - 16/20. 62% 31% 8%, = 101%; Heqje zgara dritare ekzistuese 63% 25% 13%, =101%; 2166 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm 38% 44% 19%, =101%; 2.300 Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah 50% 32% 19%, =101%; 2.491/c F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, PN . 16 48% 40% 13%, =101%; 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks (d54x9) 44% 19% 38%, =101%; 2.494 F.V Saracineska bronzi Ø ½ " = 15 mm 63% 25% 13%, =101%; 2.494/1 F.V Saracineska bronzi Ø ¾ " = 20 mm 56% 17% 28% =101%; 2.493/1 F.V.Tubo çeliku pa tegel ASTM, A106GR DN 4" 35% 35% 31% , =101%; Sistemi i shkarkimit te ujrave te zeza 42% 33% 26% =101%”, vërejmë se,*

III.2.1. Operatorët ekonomikë “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr.1674 rep Nr.849 Kol datë 10.09.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit *“Rikonstruksion i Spitalit Rajonal Kukes”-faza I (blloku operator dhe urgjenca , maternitetit, administrata), me fond limit 163.832.500 leke pa TVSH, zhvilluar nga Spitali Rajonal Kukës.*

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Shoqëria Lala shpk do të kryejë 40% të punimeve sipas tabelës së ndarjes së punimeve. Shoqëria Shansi Invest shpk do të

kryejë 30% të punimeve sipas tabelës së ndarjeve të punimeve. Shoqëria Biba X shpk do të kryejë 30% të punimeve sipas tabelës së ndarjeve të punimeve [...]”

III.2. Konstatohet se bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit BOE ankimes ka paraqitur tabelën e ndarjes së punimeve në përqindje midis tre anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë. Autoriteti kontraktor pretendon se për zërat Prishje mur tulle pa pastrim 26% 31% 44%; 2.426/6 Prishje mure beton/arme 33% 33% 33% ; Analiz Heqje dyer dritare duralumini të ripërdorshme 38% 50% 13%, =101%; 2.291 Bordura trotuari 25x12cm te derdhura ne vend 50% 33% 18%, =101%; 2.114/1 Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m3 C - 16/20. 62% 31% 8%, = 101%; Heqje zgara dritare ekzistuese 63% 25% 13%, =101%; 2166 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm 38% 44% 19%, =101%; 2.300 Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah 50% 32% 19%, =101%; 2.491/c F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, PN. 16 48% 40% 13%, =101%; 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks (d54x9) 44% 19% 38%, =101%; 2.494 F.V Saracineska bronzi Ø ½ " = 15 mm 63% 25% 13%, =101%; 2.494/1 F.V Saracineska bronzi Ø ¾ " = 20 mm 56% 17% 28% =101%; 2.493/1 F.V.Tubo çeliku pa tegel ASTM, A106GR DN 4" 35% 35% 31% , =101%; Sistemi i shkarkimit te ujrave te zeza 42% 33% 26% =101%”, mbledhja e përqindjeve që secili anëtar ka marrë përsipër del më e madhe se 100%.

Sa më sipër konstatohet se përqindja e referuar nga autoriteti kontraktor për disa nga zërat e punimeve nuk është e njëjtë me përqindjen që BOE ankimes ka përcaktuar në preventivin e ndarjes së punimeve. Konkretisht për zërat Analiz Heqje dyer dritare duralumini të ripërdorshme, 2.291 Bordura trotuari 25x12cm te derdhura ne vend , 2.114/1 Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m3 C - 16/20.

Ndërsa për zërat 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks (d54x9) 2.494/1 F.V Saracineska bronzi Ø ¾ " = 20 mm Heqje zgara dritare ekzistuese % e përcaktuar nga BOE ankimes është parashikuar në masën 100%. Konkretisht zërat Heqje zgara dritare ekzistues sipas tabelës së ndarjes së punimeve është përcaktuar 50 % 25% 25 % pra 100 % dhe jo 101 % si është shprehur autoriteti kontraktor zeri 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks sipas tabelës së ndarjes së punimeve është përcaktuar 42 % 33 % 25% pra 100 % dhe jo 101 % si është shprehur autoriteti kontraktor zerin 2.535/f F.V.Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks (d54x9) 2.494/1 sipas tabelës së ndarjes së punimeve është përcaktuar 42 % 33 % 25 % pra 100 % dhe jo 101 % si është shprehur autoriteti kontraktor..

Pra, konstatimi i autoritetit kontraktor në arsyen e skualifikimit nuk është i saktë. Akoma më tej gjykojmë se diferenca +- me 1% nuk ndikon në masën e përqindjes që ka marrë secili nga anëtarët e bashkimit në kontratën e bashkëpunimit dhe i gjen të drejta pretendimet e BOE ankimes se në momentin e reflektimit të përqindjeve shifrat mbas presjeve nuk janë reflektuar pasi ishin lidhje periodike ose shumë të gjata (në varësi nga mënyra e ndarjes të saive të preventivit) ka rezultuar si vijon psh: zëri i punimeve Sistemi i Shkarkimit të Ujrave të Zeza e ndarë ndërmjet 3 kompanive me e paraqitur në tabelën e ndarjes së punimeve me nga 42% 26% 33% . Kjo nuk do të thotë se ndarja e punimeve është 101% por që në momentin e reflektimit të përqindjeve nga mënyra si është ndarë ky zë ka bërë që 1% të reflektohet. Konkretisht përqindja që përfaqëson secila kompani me dy shifra pas presjes është 41.63%+25.58%+32.78%=99.99%, pra, 100%.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, rezulton se është bërë një ndarje e saktë dhe e qartë në deklaratën e bashkëpunimit të përqindjes së punëve që do të kryejë secili operator ekonomik si anëtar i bashkimit të përkohshëm, e përlllogaritur kjo respektivisht për secilin zë të marrë përsipër për t'u kryer nga secili operator ekonomik anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

Ky është rasti i rrumbullakosjes së shifrave pas presjes dhe paraqitje përqindje me numër të plotë, ku në legjislacionit për prokurimin publik përcaktohet në mënyrë të qartë ndarja e përqindjes së punëve në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Mjafton të bëhet një llogaritje në sistemin e Excel ku shprehet shumë qartë që llogaritja në vlerë dhe përqindje është e saktë.

Gjykojmë se në aktmarreveshje përcaktohen në mënyrë të qartë % dhe reflektimi me % për disa zera kanë ndodhur për shkak të dy shifrave pas presjes e cila kalon me rrumbullakosje.

Sa më sipër, gjykojmë se nga ana e operatorit ekonomik ankimes është bërë ndarja e saktë e punëve të marra përsipër nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, në elementë konkretë dhe të detajuar, në kundërshtim kjo në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimes qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se *“Kontrata me Inxhinierin e ndertimit z. Agur Shehaj ka mosperputhje të datës së lidhjes së kontratës me datën e hyrjes në fuqi të saj , pasi ajo është lidhur me datë 12.03.2015 por në nenin 4 të saj shprehet se kjo kontratë lidhet nga data 02.01.2015 dhe në Kodin e Punes nuk njihen kontratat me prapaveprim , pra na shtyn të besojmë në fiktivitetin e kësaj kontrate.*

Kontrata me Inxhinierin e ndertimit z. Genc Ajazi ka mosperputhje të datës së lidhjes së kontratës me datën e hyrjes në fuqi të saj , pasi ajo është lidhur me datë 13.02.2017 por në nenin 4 të saj shprehet se kjo kontratë lidhet nga data 28.01.2017 dhe në Kodin e Punes nuk njihen kontratat me prapaveprim , pra na shtyn të besojmë në fiktivitetin e kësaj kontrate”, vërejmë se,

III.3.1. Në shtojcën “Modifikim mbi dokumentat e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori Ekonomik duhet të vertetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operator ekonomik duhet të paraqesë propozimin e tij (sipas tabelës së mëposhtme) me emrin e inxhinierit për secilin post, shoqëruar me diplomë, kontratë pune të vlefshme dhe CV për secilin inxhinier, si dhe të jenë të pasyruar në listëpagesat e operatorit ekonomik prej Janar 2018 e në vazhdim, për:*

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier hidroteknik

1 (një) Inxhinier gjeodet

1 (një) Inxhinier elektrik

1 (një) Inxhinier mjedisi

NR	INXHINIERI	EMRI MBIEMRI	SHOQERIA KU ESHTE I PUNESUAR
1	Inxhinjer ndërtimi		
2	Arkitekt		
3	Inxhinier hidroteknik		
4	Inxhinier gjeodet		
5	Inxhinier elektrik		
6	Inxhinier mjedisi		

Ne rastet e bashkimit të Operatoreve Ekonomike propozimi duhet të firmoset nga të gjitha shoqëritë e bashkimit.

III.3.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet se në përmbushje të kriterit sa më sipër BOE ankimes ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Individuale Pune Nr.269 Rep Nr.166 Kol datë 12.03.2015 lidhur përpara noterit ndërmjet punëdhënësit “Lala” shpk dhe punëmarrësit Augur Shehaj në pozicionin Ing. Ndërtimi me specialitet ndërtime Hidroteknike, rruga ura , me detyrë Drejtues Teknik . Kohëzgjatja e kontratës 5 vjet duke filluar nga data 02.01.2015 deri më datë 01.01.2020.
- Kontratë Individuale Pune Nr.415 Rep Nr.127 Kol datë 13.02.2017 lidhur përpara noterit ndërmjet punëdhënësit “Shansi Invest” shpk dhe punëmarrësit Genc Ajazi me detyrë Drejtues Teknik Ing.Hidroteknik. Kjo kontratë lidhet për një periudhë 5 vjecare duke filluar nga data 28.01.2017 deri 27.01.2020 me të drejtë rinovimi.

Public Health Sector

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”

III.3.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.3.5. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjykojmë se kriteret e kualifikimit i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë paisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si edhe personelin e nevojshëm, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe për të krijuar një panoramë të qartë mbi stafin, marrëdhëniet e punës dhe vijueshmërisë së tyre.

III.3.6. Në Nenin 21 pika 1 të Ligjit Nr. 7961 dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH-së”, i ndryshuar, parashikohet se *“Kontrata e punës mund të lidhet dhe ndryshohet me gojë ose me shkrim. Ajo mund të ndryshohet vetëm në marrëveshje midis palëve. Çdo ndryshim i kontratës së shkruar, në dëm të punëmarrësit, duhet të përfundohet me shkrim”*. Gjithashtu në pikën 4 të po këtij neni parashikohet se *“Kur kontrata e punës lidhet me gojë, punëdhënësi është i detyruar që, brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, të hartojë me shkrim dokumentin përkatës, të nënshkruar prej tij dhe punëmarrësit, ku të përfshihen sidomos elementet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Moshartimi i këtij dokumenti me shkrim nuk cenon vlefshmërinë e kontratës, por sjell vetëm përgjegjësinë e punëdhënësit, sipas nenit 202 pika 2 të këtij Kodi”*.

III.3.7. Sa më sipër, kontrata e punës është një marrëdhënie e krijuar ndërmjet palëve, të cilët me vullnetin e tyre të lirë, për realizimin e funksioneve të tyre si edhe një marrëdhënie e pavaruar që nuk ndikohet nga kushtet e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.

Kontrata e lidhur ndërmjet tyre është një veprim juridik, që referuar Kodit Civil, është “shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”. Kontrata e lidhur mes palëve është një veprimtari apo marrëdhënie e brendshme, e cila mund të jetë edhe e ndryshueshme në kohë.

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, operatori ekonomik të vërtetojë se disponon kapacitete në lidhje me eksperiencat e mëparshme, makineritë e pajisjet, punonjësit dhe personelin e duhur, etj., duke realizuar edhe qëllimin e vendosjes së këtyre kriterëve, për të kualifikuar një shoqëri që plotëson të gjitha kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor. Konkretisht, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatori ekonomik të ketë paraqitur dokumentacion në lidhje me inxhinierat e sipërcituar, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit në rastin konkret kontrata pune. Mospërputhja e konstatuar nga autoriteti kontraktor në kontratat e paraqitura konkretisht në nenin 4 të kontratës “kohëzgjatjen e kontratës” në gjykimin tonë është tejet e parëndësishme dhe nuk ndikon në vlefshmërinë e dokumentit të paraqitur nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të operatorëve. Për më tepër që kontrata e paraqitura janë lidhur përpara noterit i cili ka detyrimin të verifikojë të gjithë elementet e kontratës në përputhje me vullnetin e shprehur nga palët. Gjykojmë se arsyeja e

skualifikimit nuk qëndron pasi anëtarët e bashkimit vërtetojnë me dokumentacion të vlefshëm se disponojnë në stafin e tyre inxhinierat e sipërcituar. Autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë për fiktivitet të kontratës për një dokument i cili lidhet përpara noterit publik dhe shpreh qartësisht vullnetin e palëve.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Lala” & “Shansi Invest” sh.p.k & “Biba-X” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se “*Inxhineria z.Dallendyshe Cengu nuk eshte ne Licencen nr. NZ .4319/5 te subjektit Biba –X shpk*”, vërejmë se,

III.4.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese propozimin e tij (sipas tabelës se mëposhtme) me emrin e inxhinierit per secilin post, shoqeruar me diplomë, kontratë pune te vlefshme dhe CV per secilin inxhinier, si dhe te jenë të pasqyruar në listëpagesat e operatorit ekonomik prej Janar 2018 e ne vazhdim, per:*

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Arkitekt

1 (një) Inxhinier hidroteknik

1 (një) Inxhinier gjeodet

1 (një) Inxhinier elektrik

1 (një) Inxhinier mjedisi

NR	INXHINIERI	EMRI MBIEMRI	SHOQERIA KU ESHTË I PUNESUAR
1	<i>Inxhinier ndërtimi</i>		
2	<i>Arkitekt</i>		
3	<i>Inxhinier hidroteknik</i>		
4	<i>Inxhinier gjeodet</i>		
5	<i>Inxhinier elektrik</i>		
6	<i>Inxhinier mjedisi</i>		

Ne rastet e bashkimit te Operatoreve Ekonomike propozimi duhet te firmoset nga te gjitha shoqerite e bashkimit.

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se anëtari bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biba X” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Individuale Pune datë 15.01.2016 lidhur ndërmjet punëdhënësit Biba X shpk dhe punëmarrësit Dallëndyshe Cengu në pozicionin Inxhinier Hidroteknik shoqëruar me diplomë, CV, librezë pune, listpagesa Janar-Qershor 2018 në të cilat figuron punonjësja D.C.
- Deklaratë datë 10.09.2018 i BOE JV Lala&Shansi Invest shpk &Biba shpk e stafit teknik sipas tabelës së sipërcituar.

III.4.3. Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]*”

Në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*”

III.4.4. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2.*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

III.4.5. Në nenin 26, pika 5 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*

Ndërsa po këtu, pika 8, përcaktohet: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.4.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Sqarojmë se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. sqarojmë se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit rezulton se është kërkuar shprehimisht se : *Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese propozimin e tij (sipas tabelës se meposhtme) me emrin e inxhinierit per secilin post, shoqeruar me diplomë, kontratë pune te vlefshme dhe CV per secilin inxhinier, si dhe te jenë të pasqyruar në listëpagesat e operatorit ekonomik prej Janar 2018 e ne vazhdim, per: 1 (një) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Arkitekt; 1 (një) Inxhinier hidroteknik; 1 (një) Inxhinier gjeodet; 1 (një) Inxhinier elektrik; 1 (një) Inxhinier mjedisi*

Konstatohet se në kriter nuk është kërkuar/ në asnjë rast që inxhinierat e kërkuar të jenë në licencën e shoqërisë dhe akomë më tej nuk është kërkuar asnjë drejtues teknik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Biba X" shpk për Inxhinier Hidroteknik Dallëndyshe Cengu rezulton se janë paraqitur kontratë pune , diplomë, CV si dhe listpagesat për periudhën Janar-Qershor 2018 në të cilat figuron e regjistruar inxhinierja D.C në përputhje me kërkesat në kriterin e kualifikimit.

Gjykojmë se autoriteti kontraktor nuk mund të pretendojë se inxhinierja D.C nuk figuron në licencën e shoqërisë "Biba X" shpk në kushtet kur ky i fundit nuk ka kërkuar që inxhinierët të jenë të pasqyruar në licencën e shoqërisë. Autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë përmbushjen e kriterëve vetëm për aq sa ka kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Gjykojmë se Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter apo specififikim tjetër i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 "Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese" pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

